

Informacione mbi infeksionin e fshehur (latent) të tuberkulozit

Çka është infeksioni i fshehtë i tuberkulozit?

Në këso rastesh personi është infektuar me tuberkuloz, mirëpo bakteret e tuberkulozit kanë ngelur në organizëm në një gjendje pauze. Personi nuk ka simptoma, ai/ajo nuk është i/e sëmurë dhe as nuk mund të infektojë me atë sëmundje persona tjerë.

Nga popullsia e botës, çdo i katërti person ka infeksionin e fshehur të tuberkulozit. Pjesa më e madhe e tyre janë infektuar në vendet në të cilat tuberkulozi është i përhapur (pot-huajse në tërë Azinë, në Afrikë, në Amerikën Jugore dhe të Mesme, në pjesë të madhe të vendeve të Europës Lindore). Në Finlandë më parë ka pasur shumë tuberkuloz. Për atë arsye shumë persona që janë lindur para vitit 1950 në Finlandë, janë infektuar me tuberkuloz gjatë fëmijërisë ose gjatë rinisë së tyre.

Pse duhet mjekuar infeksionin e fshehur të tuberkulozit?

Qëllimi i mjekimit është të shkatërrojë bakteret e tuberkulozit që fshehën në organizëm dhe në atë mënyrë të parandalojë sëmurjen.

Infeksioni i fshehur i tuberkulozit mund të aktivizohet në ndonjë kohë, madje edhe nëse nga infektimi kanë kaluar me dhjetëra vite. Në asi rasti personi sëmurët, ka simptoma dhe mund të infektojë me tuberkuloz edhe të afërmit e vet. Rreziku për t'u sëmurë është më i madh në dy vitet e para pas infektimit. Pas kësaj kohe sëmurja mund të jetë pasojë e dobësisë të përkohshëm ose të përhershëm të sistemit mbrojtës të organizmit.

Infeksioni i fshehur i tuberkulozit kërkohet te ata persona, të cilët kanë rrezikshmëri të madhe për t'u sëmurë

Ndër personat më të ekspozuar ndaj infektimit me tuberkuloz janë të afërmit e të sëmurit, si për shembull personat që banojnë në të njëjtën amvisni me të. Autoritetet shëndetësore caktojnë grupin e njerëzve që do të hulumtohet. Vetëm një e treta e të ekspozuarve infektohet me tuberkuloz.

- Nga njëqind persona të rritur të infektuar me tuberkuloz afërsisht një dhjetë prej tyre sëmurën prej tuberkulozit. Gjysma e tyre brenda dy vitesh e gjysma tjetër më vonë gjatë jetës së tyre.
- Prej fëmijëve të moshës nën 1- vjeçare çdo i dyti dhe prej fëmijëve të moshës 1-5 vjeçare çdo i katërti mund të sëmurët pasi të infektohet. Edhe tinxherët dhe të rinjtë janë më të rrezikuar të sëmurën sesa personat e moshuar. Për këtë arsye infektimet gjurmohen te personat e ekspozuar të moshës nën 35 - vjeçare.
- Në riskun e sëmurjes ndikon drejtpërdrejt imuniteti i organizmit. Ekzaminimet bëhen pavarësisht nga moshë nëse i ekspozuari ka ndonjë sëmundje ose terapi me barna që ia dobësojnë imunitetin.

Sëmundjet, terapitë me barna dhe intervenimet e ndryshme, të cilat shkundin sistemin mbrojtës të organizmit, me rastin e të cilave bëjmë ekzaminime:

- Infeksioni HIV
- Silikoza (mushkëritë me pluhur kristalor, p.sh. te minatorët)
- Me rastin e planifikimit të transplantimit të organeve

- Në rastet kur funksionimi i mangët kronik i veshkave avancon aq shumë sa që kërkohet trajtim me veshka artificiale
- Me rastin e planifikimit të mjekimit me barna biologjike ose të fillimit të barnave parandaluese JAK.

Si e sqarojmë infeksionin e fshehur të tuberkulozit?

Te të rriturit përdorim testin e gjakut (IGRA, Interferon Gamma Release Assay), te fëmijët e moshës nën 7 - vjeçe përdorim edhe testin e lëkurës (Mantoux).

Si e mjekojmë infeksionin e fshehur të tuberkulozit?

Para fillimit të mjekimit verifikojmë që personi të mos ketë simptoma që i referohen tuberkulozit dhe që pasqyra e mushkërive të jetë normale. Nëse është e nevojshme, marrim mostrat e pështymës. Në analizat e gjakut kontrollojmë hemoglobinën, rruazat e bardha, vlerat e mëlçisë dhe të veshkave si dhe testin e HIV-it.

Vendimi mbi fillimin e mjekimit merret pas shqyrtimit dhe bisedës individuale. Mjekimi me barna fillohet vetëm nëse personi ka dëshirë dhe zotohet për t'iu përmbajtur mjekimit. Mjekimi fillohet dhe përcillet në kujdesin shëndetësor publik (në spital ose në Qendër Shëndetësore). Sipas Ligjit mbi pagesat e pacientit, ekzaminimet dhe mjekimi janë pa pagesë.

Për mjekim përdorim barna kundër tuberkulozit. Mjeku bën zgjedhjen e barnave ose kombinimit të barnave që i përshtaten më së miri secilit rast veç e veç. Mjekimi zgjatë 3-9 muaj, varësisht nga gjendja dhe nga kombinimi i barnave. Nga mjekimi mund të ketë edhe ndikime të dëmshme. Lexo më shumë për këtë në udhëzimin e veçantë për pacientë.

Sa është efikas mjekimi me barna?

Me anë të mjekimit me barna mund të parandalohet zhvillimi i sëmundjes së tuberkulozit te shumica e atyre që kanë marrë trajtimin e plotë.

A mund të merret mjekimi me barna gjatë kohës së shtatzënisë?

Nëse shtatzënia është akoma në fazën e planifikimit, është më mirë që së pari të çohet deri në fund mjekimi LTBI para fillimit të shtatzënisë.

Gjatë kohës së shtatzënisë risku nga infeksioni i mëlçisë për nënën është i rritur deri diku. Për këtë arsye, mjekimi është mirë të fillohet nja tre muaj pas lindjes. Vendimi mbi mjekimin merret çdo herë në mënyrë individuale, pas shqyrtimit të hollësishëm. Barnat e tuberkulozit nuk i shkaktojnë rrezik embrionit.

Kujdesu për veten tënde!

Ti mund të përforcosh imunitetin me anë të mënyrës tënde të jetesës. Pra, kujdesu për veten tënde. Ha ushqim të shumëllojshëm, lëviz dhe fli mjaftueshëm. Lëre duhanin dhe përdor alkool me karar (me masë). Shmang stresin. Përdor vitaminë D: lëkurëbardhët duhet të përdorin vitaminë D së paku nga tetori deri në prill ndërsa zeshkanët përgjatë tërë vitit.

Kontakto me mjekun nëse të shfaqet kollë për një kohë më të gjatë, këlbazë, të kollitura, humbje të oreksit, humbje të peshës, lodhje të madhe ose djersitje gjatë natës.

Më shumë rreth tuberkulozit: www.tuberkuloosi.fi